



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 1681 Prot.

Lezhë, më 03 . 02 . 2021

VENDIM

Nr 17 , Datë 03 / 02 / 2021

**“PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË SUBJEKTEVE PËR FITUESE PËR GRANTE
RINDËRTIMI PËR SHTËPITË INDIVIDUALE DHE BANESA NË NDËRTESA
(PALLATE) ME SHKALLË DËMTIMI DS4 DHE DS5 SIPAS ANALIZAVE TË
THELLUARA TË INSTITUTIT TË NDËRTIMIT NË BASHKINË LEZHË”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 29, pika 1, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, nenit 3, pika 23, nenit 7, pika 1, nenit 30, nenit 42, pika 1, shkronjat “b” dhe “d”, të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Vendimit i Këshillit të Ministrave Nr.750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmëve të shkaktuara nga fatkeqësia natyrore ose fatkeqësitë e tjera të shkaktuara nga veprimet njerëzore”, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, i ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.282, datë 09.04.2020 “Për disa ndryshime në vendimin nr.5, datë 06.01.2020, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, VKB nr.79, datë 25.06.2020 “Për miratimin e vertetimit të lëshuar nga Kryetari i Fshatit dhe Administratori i Njësisë Administrative, si dhe dokumentacionit tjetër plotësues, që vertetojnë posedimin dhe gëzimin e vazhduar të banesave, si dhe vertetimit të legalizimit dhe formularit të aplikimit, si dokumentacion që provojnë pronësinë e objektit për aplikuesit për programin e

rindertimit”, VKB nr. 22, datë 14.02.2020 “Për miratimin e manualit për procedurat e përfitimit nga programet e procesit të rindertimit për strehim”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së subjekteve përfituese për grante rindertimi për shtëpitë individuale dhe banesa në ndërtesa (pallate) me shkallë dëmtimi DS4 dhe DS5 sipas analizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit në Bashkinë Lezhë, sipas aneksit nr.1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Miratimin e listës së subjekteve përfituesve, për grante rindertimi për në banesa individuale dhe ndërtesa (Pallate), për kategoritë DS4 dhe DS5 sipas analizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit të cileve ju është pranuar ankimi ndaj vendimeve të Komisioneve të Posacme të Vlerësimit, sipas aneksit nr.2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi administrata e Bashkisë Lezhë.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

SEKRETARI

FLORIDA ÇUNAJ



KRYETARI

ERNEST RAKAJ

